

**VENDIM**  
**Nr.68, datë 13.09.2006**

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR MBIKËQYRJEN E SHOQËRIVE TË KURSIT - KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 1, pika 3 të ligjit nr.8365, datë 2.07.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 47, pika 2 të ligjit nr.8782, datë 3.5.2001 “Për shoqëritë e kursit - kreditit”, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

**V E N D O S I:**

1. Në rregulloren “Për mbikëqyrjen e shoqërive të kursit - kreditit dhe të unioneve të tyre”, miratuar me vendimin nr. 43, datë 8.6.2005 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, pika 1 e nenit 7 të ndryshohet si më poshtë:

“Raporti i kapitalit me tepicën neto të portofolit të kredive pas zbritjes së provigjoneve të jetë jo më i vogël se 5 për qind në dy vitet e para të aktivitetit të kredihënies pas marrjes së licencës dhe jo më pak se 8 për qind pas dy viteve të para.”

2. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**KRYETARI**

**Ardian Fullani**